



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRI E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No.	2524	Nr. i faqj. Br. str. / No. pg. 5
Data / Datum / Ente:	21/10/2022	Pojë / Pëc

## Rregullore për punën e Këshillit për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Tetor 2022

Në bazë të nenit 7, të Rregullores për Sistemin e Sigurimit dhe Vlerësimin të Cilësisë, të Universitetit "Haxhi Zeka", në Pejë, Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.10.2022, miratoi këtë rregullore.

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Në këtë Rregullore përcaktohet organizimi, funksionimi, detyrat dhe procedurat vendimmarrëse të Këshillit për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim.

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet për Këshillin për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim.

#### **Neni 3**

##### **Organizimi i KMCV-së**

1. Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim është organ këshillues i Senatit dhe Rektorit, i cili në bashkëpunim me përgjegjës/organe të tjerë mbështetës dhe profesional të Universitetit, planifikon, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimin të procesit mësimor, hulumtimit shkencor, kërkimit artistik dhe të gjitha vlerësimet e fushave tjera që mbuloohen nga universiteti.
2. KMCV përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë.
3. Anëtarët e KMCV-së ashtu siç përcaktohen edhe në nenin 7, paragrafi 2, i Rregullores për Sistemin e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësim, janë si në vijim:
  - 3.1. Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të cilësisë (i përhershëm) – Kryesues;
  - 3.2. Pesë përfaqësues nga njësitë akademike të Universitetit (staf akademik/profesorë), të cilët propozohen nga Këshilli i Njësisë Akademike;
  - 3.3. Drejtori i Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim (i përhershëm);
  - 3.4. Zyrtari ligjor në nivel qendror (i përhershëm);
  - 3.5. Dy përfaqësues nga Studentët me notë mesatare mbi tetë (8).

#### **Neni 4**

##### **Mandati i anëtarëve të KMCV**

1. Anëtarët e KMCV-së kanë mandat të përhershëm dhe jo të përhershëm.
2. Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë, Drejtori i Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, Zyrtari ligjor në nivel qendror, kanë mandat të përhershëm;
3. Anëtarët përfaqësues të njësive akademike kanë mandat tre (3) vjeçar;
4. Anëtarët përfaqësues të studentëve kanë mandat një (1) vjeçar (1 tetor – 30 shtator).
5. Anëtarët jo të përhershëm do të votohen nga Senati i Universitetit.

## **Neni 5**

### **Detyrat e Këshillit për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim janë:**

1. I propozon Rektorit dhe Senatit një strategji me udhëzimet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, kriteret, standardet dhe procedurat për realizimin e saj dhe përmirësimin e vazhdueshëm;
2. Harton Manualin e Sigurimit të Cilësisë;
3. Harton dhe aprovon planin e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në nivel qendror dhe të njësive akademike, në përputhje me këtë rregullore, akteve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, dhe dokumenteve tjera për sigurimin e cilësisë;
4. I jep sugjerime Rektorit, Senatit, Komisioneve të njësive akademike, për përmirësim të nivelit të cilësisë;
5. Inkurajon diskutimet për cilësinë dhe promovon kulturën e cilësisë brenda universitetit;
6. Analizon të dhënat e mbledhura nga fushat e ndryshme;
7. Themelon dhe mbikëqyr grupet punuese ad hoc për hartimin e RVV institucionale;
8. Shqyrton RVV institucional të hartuar nga grupet punuese sipas fushave përkatëse të Manualit të AKA-së;
9. Shqyrton dhe i propozon Senatit aprovimin e raporteve të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim të Programeve të Studimit;
10. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë dhe dekanët, zgjedhë anëtarët e komisioneve ad-hoc në nivel qendror për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës;
11. Aprovon raportet e përpiluara nga Zyra për sigurim të cilësisë dhe vlerësim, dhe jep rekomandime për përmirësim të cilësisë bazuar në rezultatet e nxjerra nga pyetësorët e realizuar;
12. Aprovon raportet e vlerësimit të Komisioneve ad-hoc, të cilat bëjnë vlerësim të brendshëm të fushave përkatëse të universitetit, jep rekomandime për përmirësim dhe ia paraqet Këshillit të Njësive Akademike dhe Menaxhmentit të Lartë.
13. Monitoron nëse rekomandimet e dhëna për përmirësim janë adresuar dhe realizuar.

## **Neni 6**

### **Mbledhjet e KMCV-së**

1. KMCV mbanë mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
2. KMCV mbanë tetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.
3. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të ftohen me kërkesë të:
  - 3.1. Kryetarit të KMCV-së,
  - 3.2. Drejtorit të Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, dhe
  - 3.3. Me kërkesë të së paku pesë anëtarëve të KMCV-së.
4. Për mbledhjet e rregullta dhe aktivitetet, KMCV vendosë për vitin kalendarik të ardhshëm, më së largu deri me 20 dhjetor të vitit paraprak.
5. Së paku pesë ditë para mbajtjes së mbledhjes së rregullt, Kryetari i KMCV-së përmes e-mailit paraqet draftin e rendit të ditës, të gjithë anëtarët e KMCV-së mund të propozojnë pika të rendit të ditës.
6. Zyrtari për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, tre ditë përpara mbledhjes përcjellë rendin e ditës përfundimtar dhe materialet e punës.
7. Kryesuesi i KMCV-së hapë dhe drejton mbledhjen, ndërsa në mungesë të kryesuesit mbledhjen e KMCV-së e drejton njëri nga anëtarët të cilin e cakton Kryesuesi.
8. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së KMCV-së është pjesëmarrja e gjashtë nga dhjetë anëtarët e përgjithshëm.
9. Të gjithë anëtarët janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e caktuara. Me përjashtim të rasteve të sëmundjes, ose angazhimeve të tjera të pashmangshme të njoftuara paraprakisht.

- Anëtarët të cilët nuk marrin pjesë në dy mbledhje radhazi, automatikisht pushojnë së qënuri anëtar, dhe zëvendësohen me anëtarin tjetër të deleguar nga organi kompetent, sipas procedurës së paraparë për emërimin e anëtarëve të KMCV-së.
10. Kryesuesi i KMCV-së ka të drejtë të ftojë në mbledhje staf akademik, administrativ, studentë, palë të jashtme, për raportim/diskutim të çështjeve të ndryshme.
  11. Zyrtari për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në nivel qendror bën përgatitjen e materialeve për mbledhje, përgatit listën për nënshkrime të pjesëmarrësve, ndërsa pas përfundimit të mbledhjes përpilon procesverbalin dhe vendimet.
  12. Të gjitha mbledhjet do të zhvillohen me përdorim minimal të materialeve të shtypura.

### **Neni 7** **Ecuria e mbledhjes**

1. Pas miratimit të rendit të ditës shqyrtohen çështjet në kuadër të pikave të parapara.
2. Të gjithë anëtarët e pranishëm mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i parqesin mendimet, propozimet lidhur me çështjet të cilat do të vendosen në mbledhje.
3. Kryesuesi jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjen e Këshillit askush nuk mund të diskutojë pa marrë fjalën nga Kryesuesi i mbledhjes.
4. Kryesuesi është përgjegjës për zbatimin e rregullores dhe veprimet e sjelljes së anëtarëve gjatë mbledhjes.
5. Kryesuesi dhe anëtarët në mbledhje janë të obliguar t'i përmbahen kësaj rregullore.
6. Kryesuesi ka të drejtë të ndërpres mbledhjen nëse konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtje të mbledhjes.
7. Për shkeljen e rregullores së punës gjatë mbledhjes mund të shqiptohen këto masa:
  - 7.1. Vërejtje, i shqiptohet të pranishmit nëse me sjellje dhe diskutime pengon punën normale të mbledhjes
  - 7.2. Marrja e fjalës, i shqiptohet anëtarit i cili me sjellje dhe deklarata çrregullon punën normale të Këshillit, për të cilin më parë i është shqiptuar vërejtje
  - 7.3. Largimi nga mbledhja, i shqiptohet anëtarit nëse edhe pas marrjes së fjalës e pengon mbarëvajtjen e mbledhjes

### **Neni 8** **Vendimmarrja**

1. Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim nxjerrë raporte, vendime, konkluzione, rekomandime, përmbledhja e të cilave publikohet në web të universitetit.
2. Vendimet merren me konsensus, nëse kërkohet një votë nga cilido anëtarë vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast të barazimit të votave, vota e kryesuesit është vendimtare.

### **Neni 9**

Për punën e vet KMCV i raporton Rektorit dhe Senatit të Universitetit.

### **Neni 10**

1. Kjo rregullore konsiderohet e aprovuar nëse për të votojnë dy të tretat e anëtarëve të KMCV-së.
2. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregullore bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse aprovimi i saj.
3. Rishikimi i rregullt i politikave të brendshme të sistemit të sigurimit të cilësisë do të bëhet sipas nevojës, e se paku çdo dy vite.

### **Neni 11**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit të saj nga KMCV.

Kryesuesi i Këshillit për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim  
Prof. Dr. Edmond Beqiri

